



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

V E N D I M

Nr. 46 datë 26.03.2026

**“PËR KALIMIN E PRONËSISË SË TRUALLIT PREJ 368 M2 TË DHËNË PËR
NDËRTIM NGA ISH KËSHILLI I RREGULLIMIT TË TERRITORIT TË RRETHIT
KORÇË NË EMËR TË TRASHËGIMTARËVE LIGJORË TË TË NDJERIT
Z. THEODHORAQ ELEZI”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës, bazuar në dispozitat e neneve 54 gërma e) të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar dhe bazuar në VKM-në 329 datë 22.05.2019 “Për përcaktimin e rregullave të bashkërendimit të punës së Bashkive me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, për regjistrimin e trojeve të dhëna për ndërtim nga njësitë e qeverisjes vendore dhe për rregullimin e mardhënieve juridike të pronësisë mbi këto troje, për efekt regjistrimi”.

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Të japë dakortësinë për nënshkrimin e kontratës noteriale për kalimin e pronësisë mbi truallin prej 368 m2 të dhënë për ndërtim nga Këshilli i Rregullimit të Territorit Korçë, me Vendim nr. 96 datë 06.12.1994 “Për dhënien e sheshit të ndërtimit për objektin Banesë sipas projektit të miratuar Parcela nr. 36 sipas planit rregullues”, në favor të trashëgimtarëve ligjorë të Z. Theodharaq Elezi, *për efekt regjistrimi në regjistrin e pasurive të paluajtshme.*

2. Të autorizohet Kryetari i Bashkisë të nënshkruajë kontratën noteriale për kalimin e pronësisë mbi truallin prej 368 m2 pjesë e pasurisë nr. 68/61 vol.02 faq. 157 Zona Kadastrale: 2716 Mollaj të Z. Theodhoraq Elezi.
3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike. (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI



Miratuar me 25 vota

Vota Pro 25

Vota Kundër 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur më datë 26-03-2026

